

N. 438 Rep.

N. 102 Kol. 13



KONTRATE THEMELUESE

Sot, me daten 18/01, 2007 (shtate), para meje Noterit, Agim XH. Robo, anetar i Dhomes se Noterise Tirane, me seli ne Rrugen: "Ismail Qemali", P. 27/1, u paraqiten personalisht:

1. Z. Arben HOXHA, person fizik, lindur ne Fier me 21.06.1975, banues ne Tirane ne adresen Rruga: "Hoxha Tahsim", Pall. 109, Shk. nr. 1, Ap. 10, me certifikate 15:88 Mj: 2 ;
2. Z. Steljo Gace, i biri i Jakupit, lindur ne Kucove me date 03.07.1955 dhe banues ne Kucove, ne adresen: Rruga "Tafil Skendo", Blloku nr. 2, me numer pasaporte Z 1100739 ;

kane hartuar, si vijon kontraten e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar:

Neni 1

FORMIMI

1. Formohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "EMPIRE" sh.p.k..
2. Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise. Per kryerjen e kesaj veprimtarie shoqeria mund te cele dege, zyra dhe filiale te saj te perfaqesimit brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ose te vendit, ku eshte hapur dega, zyra ose filiali. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e vet ne baze te ketij Akti Themelimi dhe Statutit.

Neni 2

Selia e shoqerise tregtare " EMPIRE" sh.p.k. eshte ne Tirane, ne adresen: Rruga "HOXHA TAHSIM", Pall. 109, Shk. nr. 1, Ap. 10.

Neni 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE


Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

- shfaqja e filmave ne sallat e kinemase;
- prodhimi dhe shperndarja ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj te filmave;
- blerja dhe shitja e filmave ne DVD, VHS;
- organizimi i aktiviteteve kinematografike dhe artistike ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj;
- organizimi dhe drejtimi i aktiviteteve ne fushen e promovimit te produkteve dhe sherbimeve te shoqerive tregtare vendase dhe te huaja, organizatave jofitimpruese vendase dhe te huaja si dhe promovimi i produkteve dhe sherbimeve;
- import – eksporti dhe tregtimi i artikujve ushqimore, import – eksporti dhe tregtimi i mobiljeve, veshjeve, lodrave, organizimi dhe menaxhimi i sherbimeve bar dhe restaurant;

Neni 4

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqërisë është 10 vjet. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kjo veprimtari mund të zgjatet tej këtij afati.



Neni 5

Shoqëria ka vulën e saj në formë katërkëndëshi me madhësi të zakonshme shkruar – Republika e Shqipërisë, Shoqëria Tregtare "EMPIRE" sh.p.k.

Neni 6

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000.00 (njëqind mijë) leke dhe perbehet nga kuotat e ortakëve të shoqërisë. Kuotat e ortakëve të Shoqërisë në kapitalin themeltar janë në raportin si vijon:

- Arben HOXHA 70 (shtatëdhjetë) %
- Steljo GACE 30 (tridhjetë) %

Zvogelimi i kapitalit themeltar nën shumën 100,000.00 leke detyron shoqërinë të shndërrohet në një formë tjetër, në rast se shoqëria nuk merr vendim për rritjen e kapitalit themeltar deri në vlerën e mesipërme. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar n.p.m. shtimit të pjesëve të saj, ortakët kanë të drejtën e rritjes së tij në mënyrë proporcionale.

Neni 7

DREJTIMI, PERFAQESIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Organet drejtuese të Shoqërisë janë Asambleja e Ortakëve dhe Administratori. Ortakët e Shoqërisë i përballojnë humbjet deri në kufirin e vlerës së tyre të derdhur në formimin e kapitalit themeltar.

Neni 8

VENDIMARRJA

Vendimet merren nga Asambleja e Ortakëve. Ortakët lajmërohen të pakten 15 dite para me leter rekomande. Në këtë leter njoftohet rendi i ditës. Lajmerimi bëhet nga administratori, ose në mungesë të tij nga eksperti kontabel i autorizuar, në rast se ka të tillë. Çdo mbledhje e Asamblesë është thirrur në mënyrë të parregullt, mund të anulohet. Asambleja e Ortakëve mund të thirret nga administratori dhe me kërkesën e ortakut, që ka më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar. Asambleja e Ortakëve thirret detyrimisht në muajin dhjetor për të miratuar programin e veprimtarisë për vitin e ardhshëm dhe në muajin mars për të miratuar bilancin kontabel të vitit të mëparshëm.

Neni 9

Në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve, vendimet merren nga ortakët, që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

Ndryshimet e Statutit vendosen nga ortakët, që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar. Në të njëjtën mënyrë vendoset edhe për zvogelimin e kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit themeltar që përfaqësojnë.

Ndalohet blerja e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqeria. Por Asambleja, qe vendos zvogelimin e kapitalit qe nuk motivohet nga humbjet, ka te drejte te autorizoj administratorin, per te blere nje numer te caktuar pjesesh, per t'i anuluar si pjese te kapitalit themeltar.

Neni 10

Administrimi i shoqerise behet nga administratori. Ne shoqerine ""EMPIRE"" sh.p.k. administrator eshte Steljo Gace, i cili vepron ne marredhenie me te tretet ne emer dhe llogari te shoqerise dhe ne te njejten kohe ka dhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithë veprimtarine e saj. Administratoret mund te zgjidhen edhe jashte bashkesise se ortakeve. Ata emerohen me vendim te ortakut, qe perfaqeson me teper se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar.

Neni 11

Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej tre vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Administratori shkarkohet me vendim te ortakut, qe perfaqeson me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqerise, me perjashtim te atyre kompetencave, qe ligji nuk i njeh. Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise. Shoqeria nuk merr persiper pasojat, kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administrimit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injeronin kete akt ne rrethanat e dhena. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja e Ortakeve, te cilat i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit ose ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballur ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Neni 12

Administratorit nuk i lejohet te kontraktoje ne cfaredo lloj forme qofte, te marre hua te shoqeria, te jape perqimin ne emer te saj, per parardhenie si dhe te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.


Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjit, te statutit apo per faje te kryera prej tij gjate administrimit te shoqerise. Pavec padise per shlyerjen e demit qe u ngarkohet personalisht, ortakët individualisht ose ne grup kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Neni 13

Eksperti kontabel i autorizuar shkarkohet nga funksioni i tij ne rast gabimi ose pengimi. Vendimi per shkarkimin e ekspertit kontabel te autorizuar merret ne te njejtat kushte si dhe vendimi per emerimin e tij.

Eksperti kontabel i autorizuar ka per detyre, duke perjashtuar cdo nderhyrje ne administrim, te verifikoje librat e llogarise dhefindet e shoqerise si dhe te kontrolloje pershtatjen e kontabilitetit te saj me legjislacionin ne fuqi.

Honoraret per pagesat e ekspertit kontabel te autorizuar i ngarkohen shoqerise. Eksperti kontabel i autorizuar detyrohet te ruaje si sekret profesional faktet, informacionet per te cilat kane mundur te vihen ne dijeni per shkak te funksionit te tij. Eksperti kontabel i autorizuar eshte pergjegjes ndaj shoqerise dhe te treteve per pasojat e demshme, qe rrjedhin nga fajet dhe nenvleresimet e tyre, gjate ushtrimit te funksionit.



Neni 14

E drejta per te nenshkruar dokumentat financiare, per te kryer te gjitha operacionet ekonomike – financiare, si dhe te gjitha veprimet me llogarite bankare te shoqerise, ne emer dhe llogari te saj, u takojne: administratorit Steljo Gace dhe ortakut Arben HOXHA.

Neni 15

SHNDRIMI I SHOQERISE DHE MBYLLJA E SHOQERISE

Shndrrimi i shoqerise ne shoqeri shoqeri kolektive ose komandite, behet me vendim unanim te Asamblese se Ortakeve. Shndrrimi i shoqerise ne shoqeri anonime behet me vendim te ortakut, qe perfaqeson me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Kjo realizohet vetem pasi shoqeria te kete hartuar dhe aprovuar nga Asambleja e Ortakeve bilancin e dy viteve te fundit te aktivitetit. Vendimi merret pasi te paraqitet raporti vjetor mbi gjendjen e shoqerise nga ana e nje eksperti per shnderrimin. Ne rast se nuk ka, caktohet nje i tille. Cdo shnderrim i bere ne kundershtrim me kete dispozite eshte i pavlefshem. Veprimtaria e shoqerise mbaron ne afatin e percaktuar ne Aktin e Themelimit dhe Statut. Veprimtaria e shoqerise mund te mbyllet edhe kur gjate dy vjeteve te njepasnjeshme veprimtaria e shoqerise nuk rezulton rentabel ose kur ortakët e shoqerise heqin dore nga shoqeria.

Neni 16

Kur shoqeria likuidohet, Asambleja mbledh komisionin e likuidimit, i cili paraqet per miratim bilancin e likuidimit te shoqerise. Mjetet financiare si dhe cdo pronesi tjeter e fituar si rezultat i veprimtarise se shoqerise, kur likuidohet, u takojne ortakeve te saj pasi te jene zbritur dhe bere pagesat per te gjithë kreditorët e shoqerise.

Neni 17

Shoqeria mund te prishet para kohe, ne rast se kapitalet e veta te shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare, rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar. Ortaket vendosin brenda kater muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne kete humbje.

Te gjitha veprimtarite e shoqerise regjistrohen ne nje liber te vecante, qe mbahet ne seline e shoqerise.


Neni 18

Palet duhet t'i zgjidhin miqesisht mosmarreveshjet e mundshme, ne rast te kundert palet do t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.


Ky Akt Themelimi hartohet ne gjuhen shqipe dhe ne kater kopje origjinale dhe perpilohet ne baze te vullnetit te lire dhe te plote te themeluesve dhe pasi lexohet me ze te larte, deklarohet se eshte kuptuar, miratohet dhe firmoset rregullisht prej tyre dhe u noteri e vertetoj ate sipas lligjit.

ARBEN HOXHA

Arben Hoxha

STELJO GACE

STELJO GACE


STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"EMPIRE" sh.p.k.

KREU I
DISPOZITAT E PERGJITHSHME



Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar ""EMPIRE" sh.p.k. eshte themeluar sipas Aktit te Themelimit dhe ketij Statuti, te perpiluar dhe te nenshkruar me vullnet te lire dhe te pavesuar, nga ortaket themelues te saj:

- 1) Arben Hoxha
- 2) Steljo Gace

Neni 2

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EMPIRE", eshte "EMPIRE" sh.p.k..

Selia e shoqerise tregtare "EMPIRE" sh.p.k. eshte ne Tirane, ne adresen: Rruga "Hoxha Tahsim", Pall. 109, Shk. Nr. 1, Ap. 10;

Shoqeria krijohet me mjetet ne pronesi private te themeluesve te saj;

Neni 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise eshte 10 vjet. Me vendim te Asamblese se Ortakeve, kjo veprimtari mund te zgjatet tej ketij afati.

Neni 4

Shoqeria Tregtare "EMPIRE" sh.p.k. eshte person juridik dhe fiton personalitet juridik, qe nga data e rregjistrimit te saj ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane. Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e themelimit te saj, Aktin e Themelimit dhe Statutin.

Neni 5


OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

- shfaqja e filmave ne sallat e kinemase;
- prodhimi dhe shperndarja ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj te filmave;
- blerja dhe shitja e filmave ne DVD, VHS;
- organizimi i aktiviteteve kinematografike dhe artistike ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj;
- organizimi dhe drejtimi i aktiviteteve ne fushen e promovimit te produkteve dhe sherbimeve te shoqerive tregtare vendase dhe te huaja, organizatave jofitimpruese vendase dhe te huaja si dhe promovimi i produkteve dhe sherbimeve;
- import - eksporti dhe tregtimi i artikujve ushqimore, import - eksporti dhe tregtimi i mobiljeve, veshjeve, lodrave, organizimi dhe menaxhimi i sherbimeve bar dhe restaurant;

Neni 6

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne territorin e Republikës se Shqipërisë. Per kryerjen e kesaj veprimtarie shoqeria mund te cele degë, zyra dhe filiale te saj te perfaqesimit brenda dhe jashte territorit te Republikës se Shqipërisë, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ose te vendit, ku eshte hapur dega, zyra ose filiali.



Neni 7

Shoqeria kryen veprimtarine per te realizuar fitimin e saj, duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit. Pjesemarrja ne shoqeri, nuk i pengon ortakët te kene pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe te drejta te tjera pronesie.

Neni 8

Shoqeria ka vulen e saj ne forme katerkendeshi me madhesi te zakonshme shkruar – Republika e Shqipërisë, Shoqeria Tregtare "EMPIRE" sh.p.k.

Neni 9

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000.00 (njëqind mijë) leke dhe perbehet nga kuotat e ortakëve te shoqërisë. Pjesët e ortakëve te Shoqërisë ne Kapitalin Themeltar jane ne raportin si vijon:

- | | |
|---------------|---------------------|
| - Arben HOXHA | 70 (shtatedhjete) % |
| - Steljo GACE | 30 (tridhjete) % |

Zvogelimi i kapitalit themeltar nen shumen 100,000.00 leke detyron shoqërine te shnderrohet ne nje forme tjeter, ne rast se shoqeria nuk merr vendim per rritjen e kapitalit themeltar deri ne vleren e mesiperme. Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar n.p.m. shtimit te pjeseve te saj, ortakët kane te drejten e rritjes se tij ne menyre proporcionale.

Neni 10

Ortaku, qe do te shese kuotat e tij, teresisht apo pjeserisht, duhet me pare te njoftoje ortakun tjeter te Shoqërisë, i cili ka te drejten e parablerjes. Kete te drejte ortaku duhet ta ushtroje brenda 30 diteve nga data e njoftimit. Ne rast te mosushtrimit te se drejtes se parablerjes, ortaku qe do te shese kuotat e tij, duhet te njoftoje emrin e bleresit dhe kushtet te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se ato te ofruara ortakut tjeter te Shoqërisë.

Neni 11

Pjesët e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashëgimie, ne rast te ndarjes se pasurise midis bashkeshortëve dhe nepermjet paraardhesve dhe pasaardhesve. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me akt noterial. Shoqeria ose te tretet duhet te respektojne keto transferime sapo t'i behen te ditura asaj. Gjithashtu pjesët e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme midis ortakëve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e ortakut, qe perfaqeson me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar.

Neni 12

Shoqeria ne emer te vet eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe ajo kryen. Shoqeria mund te shese pasuri ose te shfrytetoje te drejta te tjera reale. Ajo mund te ofroje per garanci dhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

Neni 13

Shoqeria krijon fond rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimn dhe nxitjen ekonomike te saj. Shoqeria disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale, qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj mbulohen nga fondi rezerve, nga fondet e tjera ose nga shumat suplementare qe, kur deshirojne, mund te derdhen prej ortakëve ne rastet kur keto detyrime nuk mund te mbulohen nga fondet ekszistuese.

KREU II

DREJTIMI, PERFAQESIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 14

Organet drejtuese te Shoqerise jane Asambleja e Ortakëve dhe Administratori. Ortaket e Shoqerise i perballojne humbjet deri ne kufirin e vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar.

Neni 15

VENDIMMARRJA



Vendimet merren nga Asambleja e Ortakëve. Ortaket lajmerohen te pakten 15 dite para me leter rekomande. Ne kete leter njoftohet rendi i dites. Lajmerimi behet nga administratori, ose ne mungese te tij nga eksperti kontabel i autorizuar, ne rast se ka te tille. Cdo mbledhje e Asamblese e thirrur ne menyre te parregullt, mund te anulohet. Asambleja e Ortakëve mund te thirret nga administratori dhe me kerkesen e ortakut, qe ka me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Asambleja e Ortakëve thirret detyrimisht ne muajin dhjetor per te miratuar programin e veprimtarise per vitin e ardhshem dhe ne muajin mars per te miratuar bilancin kontabel te vitit te meparshem.

Neni 16

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar, qe ai zoteron. Ortaku mund te perfaqesohet edhe nga nje person tjetër, por ky perfaqesim duhet te jete vetem me ane te nje akti noterial.


Neni 17

Ne mbledhjet e Asamblese te Ortakëve, vendimet merren nga ortakut, qe perfaqeson me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar.



Ndryshimet e Statutit vendosen nga ortaku, qe perfaqeson me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Ne te njejten menyre vendoset edhe per zvogelimin e kapitalit themeltar. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit themeltar qe perfaqesojne.

Ndalohe blerja e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqeria. Por Asambleja, qe vendos zvogelimin e kapitalit qe nuk motivohet nga humbjet, ka te drejte te autorizoj administratorin, per te blere nje numer te caktuar pjesesh, per t'i anuluar si pjese te kapitalit themeltar.



Neni 18

Ortaket mund te emerojne nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar. Vendimi per emerim merret nga ortaku, qe perfaqeson me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar.

Neni 19

ADMINISTRIMI

Administrimi i shoqerise behet nga administratori. Ne shoqerine "EMPIRE" sh.p.k. administrator eshte Steljo Gace, i cili vepron ne marredhenie me te tretet ne emer dhe llogari te shoqerise dhe ne te njejten kohe ka dhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithë veprimtarine e saj. Administratoret mund te zgjidhen edhe jashte bashkesise se ortakeve. Ata emerohen me vendim te ortakut, qe perfaqeson me teper se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar.

Neni 20

Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej tre vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Administratori shkarkohet me vendim te ortakut, qe perfaqeson me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqerise, me perjashtim te atyre kompetencave, qe ligji nuk i njeh. Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise. Shoqeria nuk merr persiper pasojat, kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administrimit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja e Ortakeve, te cilat i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit ose ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballur ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Neni 21

Administratorit nuk i lejohet te kontraktoje ne cfaredo lloj forme qofte, te marre hua te shoqeria, te jape perqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjit, te statutit apo per faje te kryera prej tij gjate administrimit te shoqerise. Pavec padise per shlyerjen e demit qe u ngarkohet personalisht, ortaket individualisht ose ne grup kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Neni 22

Ortakët mund të emerojnë një ose disa eksperte kontabel të autorizuar. Vendimi merret nga ortakët, që përfaqësojnë me shumicë të gjysmës së pjesëve të kapitalit themeltar. Eksperti kontabel i autorizuar emerohet për një periudhë prej 6 vitesh financiare.

Cdo ortak joadministrator ka të drejtë dy herë në vit t'i paraqesë me shkrim administratorit pyetje për probleme, që vëjnë në dyshim vazhdueshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë. Përgjigja e administratorit i komunikohet ekspertit kontabel të autorizuar.

Cdo shqyrtim i bërë pa caktuar ekspertë kontabel të autorizuar në rastet e detyruara me ligj ose shqyrtimet e raporteve të eksperteve kontabel të autorizuar, të cilët janë emëruar apo kanë mbetur në detyrë në kundërshtim me Ligjin nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", neni 68, konsiderohen të pavlefshme.

Neni 23

Eksperti kontabel i autorizuar shkarkohet nga funksioni i tij në rast gabimi ose pengimi. Vendimi për shkarkimin e ekspertit kontabel të autorizuar merret në të njëjtat kushte si dhe vendimi për emërimin e tij.

Neni 24

Eksperti kontabel i autorizuar ka për detyrë, duke përjashtuar cdo nderhyrje në administrim, të verifikojë librat e llogarive dhe fondet e shoqërisë si dhe të kontrollojë përshatjen e kontabilitetit të saj me legjislacionin në fuqi.

Honoraret për pagesat e ekspertit kontabel të autorizuar i ngarkohen shoqërisë. Eksperti kontabel i autorizuar detyrohet të ruajë si sekret profesional faktet, informacionet për të cilat kanë mundur të vihen në dijeni për shkak të funksionit të tij. Eksperti kontabel i autorizuar është përgjegjës ndaj shoqërisë dhe të tjerëve për pasojat e demshme, që rrjedhin nga fajet dhe nënvlerësimet e tyre, gjatë ushtrimit të funksionit.

KREU III

VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE DHE NDARJA E FITIMEVE

Neni 25

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të veprimtarisë kontabel dhe pasqyrohet në bilancin e saj. Viti financiar fillon më 01 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor. Përjashtimisht viti i parë financiar fillon në ditën që shoqëria fiton personalitetin juridik dhe përfundon më 31 dhjetor të po atij viti.

Neni 26

Llogaritë vjetore, inventari, raportet, operacionet e veprimtarisë së vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Asambleja e Ortakëve. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar. E drejta për të nënshkruar dokumentat financiare, për të kryer të gjitha operacionet ekonomike – financiare, si dhe të gjitha veprimet me llogaritë bankare të shoqërisë, në emër dhe llogari të saj, u takojnë: administratorit Steljo Gace dhe ortakut Arben HOXHA.

Neni 27

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si dhe fondet e lena reserve per nxitjen ekonomike, investime, per reklamen tregtare etj, perfitohen prej ortakeve themelues te kesaj shoqerie. Bilanci vjetor i shoqerise brenda 31 marsit te vitit pasardhes.



KREU IV MARREDHENIET E PUNES

Neni 28

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen sipas legjislacionit shqiptar dhe me kete statut. Vendimi per fillimin e marredhenieve te punes, nderprerjen e tyre, merret nga ortaku qe perfaqeson me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Punesimi i punonjesve behet mbi bazen e kontrates kolektive dhe individuale te punes. Ne kontraten e punes rregullohen kryesisht keto ceshtje:

- kushtet e punes dhe menyra e marredhenies se punes;
- fillimin e marredhenieve te punes dhe caktimi i tij ne vendin e punes;
- koha e punes;
- pushimi i marredhenieve te punes;
- paga e punonjesit, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera;

Neni 29

Per te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

KREU V

SHNDERRIMI I SHOQERISE DHE MBYLLJA E SHOQERISE

Neni 30

Shndrrimi i shoqerise ne shoqeri shoqeri kolektive ose komandite, behet me vendim unanim te Asamblese se Ortakeve. Shndrrimi i shoqerise ne shoqeri anonime behet me vendim te ortakut, qe perfaqeson me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Kjo realizohet vetem pasi shoqeria te kete hartuar dhe aprovuar nga Asambleja e Ortakeve bilancin e dy viteve te fundit te aktivitetit. Vendimi merret pasi te paraqitet raporti vjetor mbi gjendjen e shoqerise nga ana e nje eksperti per shnderrimin. Ne rast se nuk ka, caktohet nje i tille. Cdo shnderrim i bere ne kundersiztim me kete dispozite eshte i pavlefshem. Veprimtaria e shoqerise mbaron ne afatin e percaktuar ne Aktin e Themelimit dhe Statut. Veprimtaria e shoqerise mund te mbyllet edhe kur gjate dy vjeteve te njepasnjeshme veprimtaria e shoqerise nuk rezulton rentabel ose kur ortaket e shoqerise heqin dore nga shoqeria.

Neni 31

Kur shoqeria likujdohet, Asambleja mbledh komisionin e likuidimit, i cili paraqet per miratim bilancin e likuidimit te shoqerise. Mjetet financiare si dhe cdo pronesi tjeter e fituar si rezultat i veprimtarise se shoqerise, kur likuidohet, u takojne ortakeve te saj pasi te jene zbritur dhe bere pagesat per te gjithë kreditoret e shoqerise.

Neni 32

Shoqeria mund te priset para kohe, ne rast se kapitalet e veta te shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare, rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar. Ortaket vendosin brenda kater muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne kete humbje.

Te gjitha veprimtarite e shoqerise regjistrohen ne nje liber te vecante, qe mbahet ne seline e shoqerise.


Neni 33

Ky Statut eshte hartuar sot me date 18.01.07 ne gjuhen shqipe dhe ne kater kopje.


Per Shoqerine "EMPIRE" sh.p.k.

ORTAKET THEMELUES


ARBEN HOXHA

Arben Hoxha


STELJO GACE

STELJO GACE


REPubLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 440 Rep.
Nr. 103 Kol.



VERTETIM

Sot me daten 18.01.2007 (shtate), u prezantuan ne Zyren Noteriale, Tirane, Rruga Ismail Qemali, P.27/1, zoterinjte Arben Hoxha (n. çert. lindje 15/88, Nj. 2) dhe Steljo Gaçe (n. pasaporte Z1100739) si përpilues te Statutit te shoqerise "EMPIRE" sh.p.k., te panjohur prej meje por qe per identitetin e te cileve u sigurova nga pasaportat perkatese, madhor e me zotesi per te vepruar. Dokumentat jane konform Ligjit te Shoqerive ne fuqi. Mbas leximit ata deklaruan se i kuptuan dhe me vullnetin e tyre te lire firmosin rregullisht para meje Noterit.

NOTERI

Agim XH. ROBO



50
LEKE
R.SHQIPERISE